



NEWSLETTER KORRIK 2022

Gjatë muajit korrik Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) ka zhvilluar tre mbledhje, gjatë të cilave u morën 7 vendime mbi fillimin e procedurave për licencim si dhe licencimin e disa subjekteve private, në aktivitetet e furnizimit, tregtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, nëpërmjet impianteve hidrike apo fotovoltaike. Futja e këtyre kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, veçanërisht të energjisë së gjelbër, si pjesë e nevojës për arritjen e targetave të Shqipërisë për diversifikimin e energjisë, siguron hedhjen në rrjetin kombëtar të një sasisë prej 10MW energji solare.

MBLEDHJE BORDI



ERE GJITHASHTU KA FILLUAR PROÇEDURËN PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BURSA SHQIPTARE E ENERGISË ELEKTRIKE - ALPEX" SH.A., NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE.

Gjatë monitorimit të Shoqërisë "Albgaz" sh.a. në lidhje me zbatimin të planit të investimeve për vitin 2021, u konstatua që në mungesë të burimeve të financimit si dhe të qasjes strategjike, Albgaz sh.a nuk ka realizuar detyrimet e parashikuara nga dispozitat ligjore e nënligjore për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2021 dhe atë 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit. Albgaz sh.a. ju rekomandua të përcjellë informacion periodik mbi zbatimin e planit të investimeve dhe përcjelljen e planeve të investimit 10 vjeçar dhe 5 vjeçar, respektivisht për aktivitetet e operimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në përputhje me parashikimet e ligjit të sektorit të gazit natyror.

MONITORIME

Gjatë monitorimit të Shoqërisë OST sh.a lidhur me mbikqyrjen e standardeve të arritura të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën janar 2021-mars 2022, u vërejt se nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë përmbushur, në disa raste dhe përmirësuar, kushtet e vendosura në rregulloren për standardet e cilësisë. Operatorit ju rekomandua vënia e prioriteteve për sa i takon planit të investimeve të cilat lidhen me zgjerimin e sistemit të SCADA në nënstacionet 110 kV.



METODOLOGJI DHE ÇMIME

Në mbledhjen e datës 21.07.2022 u miratua metodologjia e llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror, ka si qëllim përcaktimin e kriterëve kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e Sistemit të Depozitimit të Gazit Natyror, bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me aktet rregullatore të miratuara nga ERE, të realizuar nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror. Tarifa për shërbimin e Depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit të gazit natyror, do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të argumentuara që Operatori i Sistemit të Depozitimit përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji.

ERE miratoi çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Qershor 2022, prej:

- 31,75 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Këto janë çmimet që do të aplikohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (funksion që aktualisht ushtrohet nga ana e FSHU) për të gjithë konsumatorët që nuk kanë arritur të gjejnë një furnizues në treg të lirë dhe marrin shërbimin e furnizimit në kushtet e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit.

FMF QERSHOR





Në mbledhjen e datës 07.07.2022, Bordi i ERE-s miratoi Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "OST" sh.a., për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit Projekti ka përfunduar në datën 20.05.2021 dhe mbështetur në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të datës 28.12.2017, palët në datën 24.11.2021 kane lidhur Marrëveshjen "Mbi procedurën e transferimit të Investimit të kryer nga zbatimi i projektit "Per instalimin e sistemit te matjes" nga OST sh.a. në OSHEE sh.a.

Sipas kësaj Marrëveshjeje, OST-ja do të realizojë transferimin e aseteve tek OSHEE sha dhe do të lejojë që ato të vihen në funksion të OSHEE-së, pas përfundimit te projektit.

Projekti i cili është një investim i Bankës Botërore do ti shërbejë hapjes së tregut të energjisë elektrike në vend pasi sistemi i matjes do ti shërbejë OSSH sh.a. Në ofrimin e shërbimit për konsumatorët e lidhur në Tensionin e Mesëm të cilët janë në treg të parregulluar si dhe do ti ofroje aksesin OST sh.a. për të kryer shërbimet e balancimit.

**TRANSFERIMI
T TË ASETEVE
TË INVESTIMIT
TË KRYER NGA
ZBATIMI I
PROJEKTIT
"FURNIZIMI
DHE INSTALIMI
I SISTEMIT TE
MATJES" NGA
OST SH.A TEK
OSHEE GROUP
SH.A.**

ANKESA

Në total gjatë muajit Korrik, janë 11 ankesa për të cilat ERE ka vijuar procedurën e shqyrtimit të ankesës, hapi i parë i së cilës është adresimi i kërkesës për informacion ose qëndrim nga i licencuari, ndaj të cilit është ushtruar ankim. Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat janë me objekt:

- Energji e pamatur/dëm ekonomik
- Mbifaturim të energjisë elektrike
- Vlerë referuese

